



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

PLANI I VEPRIMIT I FAKULTETIT JURIDIK 2024/2025

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Vështrim i shkurtër rreth programit
3. Vizioni, misioni dhe qëllimi i Fakultetit Juridik
4. Ngritja e nivelit të cilësisë për programet ekzistuese
5. Stafi akademik
6. Studentët
7. Buxheti
8. Infrastruktura: Përmirëson ambientet, teknologjinë dhe burimet e bibliotekës
9. Hulumtimet shkencore
10. Ndërkombëtarizimi
11. Programet aktuale aktive - viti akademik 2024/2025
12. Krijimi i programit/eve master - Programe të reja të synuara për akreditim-viti akademik
13. Gjendja aktuale e ndërlidhjes së fushave drejtësi-teknologji
14. E ardhmja dhe profilizimi – ndërlidhja me IT
15. E ardhmja dhe profilizimi – Marrëveshjet e UKZ-së- ndërlidhja Drejtësi-IT
16. Përmbledhje e planit të zhvillimit të Fakultetit Juridik
17. Përkushtimi për rishikim të vazhdueshëm, adaptim dhe përmirësim të tij
18. Plani i detajuar i veprimit i Fakultetit Juridik, miratuar nga Keshilli i Fakultetit Juridik

1. Hyrje

Plani i Veprimit i Fakultetit Juridik është përgatitur nga personeli akademik i Fakultetit Juridik me qëllim që institucionit akademik, stafit akademik dhe studentëve t'ju shërbejë si një udhërrëfyes në drejtim të zhvillimit të përgjithshëm akademik.

Plani i Veprimit i Fakultetit Juridik do të jetë në harmoni të plotë me të gjithë kornizën normative të *Universitetit Publik "Kadri Zeka"*, më tej (UKZ).

Përmes *Planit të Veprimit të Fakultetit Juridik* do të përcillen të dhënat bazike që nga paraqitja e shkurtër e zhvillimit të Fakultetit Juridik, vizionit, misionit dhe qëllimeve fundamentale të kësaj njësie akademike.

Gjithësesi, në pika të shkurtëra do të paraqiten edhe të dhënat në lidhje synimet për avancimin e menaxhimit të cilësisë brenda programeve studimore, të dhënat për stafin akademik, studentët, buxhetin, çështjeve që kanë të bëjnë me infrastrukturën si dhe të dhëna të tjera të cilat lidhen e aspektin e hulumtimeve shkencore dhe ndërkombëtarizimit jo vetëm të UKZ-së në tërësi por edhe të kësaj njësie akademike në veçanti.

Natyrisht, do të paraqiten edhe programet aktuale aktive si dhe synimet për të ardhmen gjithnjë në kuptim të zhvillimit të programeve të reja dhe në harmoni me kërkesat e tregut të punës.

Një çështje tjetër që do të paraqesim në kuadër të këtij *Planit të Veprimit të Fakultetit Juridik* do të jetë edhe trajtimi i së ardhmes së Fakultetit Juridik në drejtim të profilizimit të tij, me theks të veçantë të ndërlidhjes së fushës së drejtësisë me IT-në.

Në fund të këtij *Plani të Veprimit të Fakultetit Juridik* do të prezanojmë një përmbledhje të sërishme të pikave kryesore të planit të theksuar duke e bërë të qartë se përpjekjet për rishikim të vazhdueshëm, adaptim dhe përmirësim të tij do të jenë vazhdimisht në fokusin e Fakultetit Juridik.

Natyrisht, tërësisht në fund, pjesë përcjellëse e këtij dokumenti do të jetë edhe tabela me të dhënat fundamentale në drejtim të pasqyrimin të tërësishëm të planit të veprimit të kësaj njësie akademike.

2. Vështrim i shkurtër rreth programit

UKZ, në Gjilan u themelua me vendimin e *Qeverisë së Kosovës* me nr. 118/03, të datës 6 mars 2013, i cili nga *Kuvendi i Kosovës* u miratua më 30 maj 2013. Themelimi i UKZ-së bëri të mundur përfshirjen në shkollimin e lartë universitar të numrit më të madh të studentëve në *Lindje të Kosovës*, të *Luginës së Preshevës*, rajonit të *Kumanovës* nga *Maqedonia Veriore* si dhe të viseve të tjera.

UKZ vazhdimisht punon për të krijuar cilësi të lartë, në të gjitha aktivitetet e saj, për të siguruar dhe përmirësuar kualitetin në mësim, studim dhe hulumtime shkencore, duke monitoruar dhe vlerësuar performancën e stafit akademik dhe duke krijuar kushtet e mësimnxënies për studentët.

Universiteti është mundësia më e mirë për një shoqëri që t'i edukojë dhe t'i bëjë të përgjegjshëm anëtarët e vet për vlerat themelore: për lirinë, parimet e demokracisë, familjen, mirëqenien ekonomike, paqen sociale dhe vlera të tjera humaniste, të cilat qëndrojnë në themel të një shoqërie me vlera të larta. Themelimi i Fakultetit Juridik mbështetet në këto dokumente:

- Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.03/118, datë: 06/03/2013;
- Statuti i Përkohshëm i Universitetit Publik të Gjilanit datë 12/08/2013 dhe
- Strategjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimit të UKZ 2017-2022.

Gjatë hartimit të raportit të vetëvlerësimit, të programit Juridik i Përgjithshëm kemi marrë në konsideratë programe të universiteteve, përkatësisht fakulteteve Juridike i: Sarajevës, Lubljanës dhe Sheffield-it.

3. Vizioni, misioni dhe qëllimi i Fakultetit Juridik

Vizioni, misioni, vlerat dhe qëllimi I UKZ-së, është po i njëjti vision, mision, vlerë dhe qëllim i njësisë akademike, përkatësisht i Fakultetit Juridik.

Rrjedhimisht, ***vizioni*** i Fakultetit Juridik shtrihet në zhvillimin e dijes, edukimit, mirëqenies së shoqërisë kosovare dhe mirëqenies së shoqërisë njerëzore. Me këtë vizion Fakulteti Juridik kontribuon drejtpërdrejtë në krijimin dhe respektimin e vlerave themelore të shoqërisë dhe kulturës moderne humaniste, si: lirinë, parimet e demokracisë, familjen, mirëqenien ekonomike, paqen sociale dhe vlera të tjera humaniste.

Misioni dhe qëllimi i Fakultetit Juridik mbetet që brenda UKZ-së si tempull i dijes të kultivojë dije dhe të përgatisë juristë të rinj të përgjegjshëm dhe profesionalisht të aftë për të qenë pjesë e një shoqërie moderne dhe globale, pjesë e një tregu më të gjerë se sa tregjet tradicionale të punës dhe njëkohësisht, model për anëtarët e tjerë të shoqërisë sonë. Pra, të përgatisë juristë të mirë.

4. Ngritja e nivelit të cilësisë për programet ekzistuese

Sigurimi i burimeve adekuate njerëzore, përcaktimi i kompetencave (caktimi dhe shpërndarja e përgjegjësiave), menaxhimi cilësor si dhe përcaktimi adekuat i formës së raportimit në lidhje me përgjegjësitë e marra, gjithnjë e më tepër do të kontribuojnë edhe në vijim, në sigurimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet akademike në Fakultetin Juridik. Për të realizuar një nivel sa më adekuat të cilësisë, në mënyrë periodike do të bëhet vlerësimi i stafit akademik si dhe i lëndëve, i cili është vlerësim i rregullt brenda UKZ-së, e në këtë kuptim edhe brenda njësisë sonë akademike, përkatësisht brenda Fakultetit Juridik. Një vlerësim i tillë do të realizohet edhe në vazhdim në dy sesione. Sesioni i parë do të përfshijë vlerësimin pas përfundimit të semestrit dimëror si dhe sesioni i dytë do të përfshijë vlerësimin pas përfundimit

të semestrit veror. Me qëllim të transparencës, Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, do të publikojë edhe në web faqen zyrtare të UKZ-së, raportin përmbledhës dhe të detajuar të një procesi të tillë, gjithnjë në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies sa më adekuate.

Duke kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në realizimin e cilësisë brenda Fakultetit Juridik, veçanërisht në realizimin e një performance akademike sa më adekuate, njësitë akademike përkatëse do të motivojnë dhe mbështetë aplikimin edhe të instrumenteve të ndryshme dhe me theks të veçantë të: raportimeve, ankesave, anketave, pyetësorëve dhe aktiviteteve të tjera të vazhdueshme të studentëve përmes të cilave ata bëhen pjesë e sigurimit dhe përmbushjes së cilësisë brenda Fakultetit Juridik. Në këtë drejtim, Fakulteti Juridik përmes: Dekanit, Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi si dhe Koordinatorit për Cilësi, do të hartojë pyetësorin i cili në mënyrë periodike do të evoluojë dhe i cili do t'i kontribuojë edhe paraqitjes së vlerësimit të studentëve në mënyrë anonime, rreth jetës akademike në tërësi në këtë njësi akademike. Kontrollimi dhe menaxhimi i cilësisë në Fakultetin Juridik-Programin Juridik i Përgjithshëm realizohet në mënyrë periodike gjë që për çdo vit akademik ky proces i rëndësishëm kalon nëpër disa stadi të domosdoshme. Rrjedhimisht:

- Stadi i parë: në javën e parë të çdo semestri vijues, mësimdhënësi do të prezantojë dhe do të ofrojë planin e tij të punës në lidhje me lëndën të cilën ai do ta ligjërojë. Syllabusi i lëndës përkatëse (të gjitha syllabuset e të gjitha lëndëve do të jenë të prezantuara në formën elektronike në ëeb faqen e UKZ-së), do t'u shpërndahet studentëve (në formë elektronike ose në kopje fizike), gjë që atyre do t'ju mundësojë orientimin adekuat në aspektin e mësimdhënies dhe mësimnxënies shumë më cilësore.

- Stadi i dytë: pas çdo ore të mbajtur, mësimdhënësi do të dorëzojë raportet me të dhënat e tematikës së shtjelluar para studentëve, me çka do t'i kontribuohet realizimit gradual të planit studimor të prezantuar nga mësimdhënësi përkatës që në fillim të semestrit akademik, përkatësisht obligimeve të marra nga mësimdhënësi në raport me njësinë akademike si dhe me studentët.

- Stadi i tretë: në fund të çdo muaji kalendarik, mësimdhënësi do të dorëzojë në njësinë akademike raportin mujor për aktivitetin e tij akademik, gjë që akoma më shumë forcon përgjegjësinë e tij në raport me njësinë akademike dhe studentët, gjithnjë në funksion të përmbushjes së planit studimor të prezantuar më parë para tyre.

- Stadi i katërt: në fund të çdo semestri, mësimdhënësi do të paraqes raport në njësinë akademike duke shpalosur të arriturat apo edhe mangësitë eventuale në realizimin planit studimor për lëndën e caktuar.

- Stadi i pestë: studentët përmes shprehjes së tyre të lirë dhe anonime, do të përgjigjen në pyetësorët e prezantuar nga Koordinatori i Cilësisë së Fakultetit Juridik, duke dhënë kështu një kontribut të çmueshëm në vlerësimin edhe të stafit akademik por edhe të lëndëve.

- Stadi i gjashtë: nga raportet e mbledhura, Koordinatorin për Cilësi i Fakultetit Juridik, do të përpunojë të dhënat, do të bëjë krahasimin e tyre, përputhshmërinë e të

dhënave të prezantuara nga mësimdhënësi me planin studimor semestral, angazhimin dhe përkushtimin e tij gjatë procesit të mësimdhënies, raporteve të vlerësimit të studentëve etj., dhe i njëjti do të arrijë që të krijojë një raport unik për secilin mësimdhënës veç e veç.

- Stadi i shtatë: nga raportet e mbledhura, dekani i fakultetit do të shkruajë Raportin vlerësues, i cili do të bëhet pjesë e dosjes personale për çdo mësimdhënës apo asistent. Rrjedhimisht, në fund të çdo semestri, por edhe në fund të çdo viti akademik, në kuadër të Fakultetit Juridik, do të publikohet në ëeb faqe të UKZ-së, Raporti përmbledhës për vlerësimin e stafit akademik dhe të lëndëve, ku në mënyrë të detajuar do të pasqyrohen të arriturat dhe mangësitë për semestrin ose vitin akademik të përfunduar. Paraqitja në formën e tillë gjithsesi se i kontribuon ngritjes së cilësisë së jetës akademike brenda Fakultetit Juridik të UKZ-së, motivon edhe më shumë stafin akademik si dhe në anën tjetër i kontribuon evidentimit të mangësive eventuale, gjithnjë me synim të eliminimit të tyre.

5. Staf i akademik

Stafi i rregullt akademik i Fakultetit Juridik është staf i profesionalizuar, përgatitur mirë por edhe i përkushtuar shumë në punë. Ky staf ka marrë pjesë në shumë konferenca shkencore vendore, regjionale dhe ndërkombëtare, ka publikuar punime kërkimore-shkencore nëpër revista kredibile ndërkombëtare, të indeksuara në Platformat Web of Science, Scopus dhe platforma të tjera. Po ashtu stafi akademik i Fakultetit Juridik, merr pjesë vazhdimisht në vizita studimore, tryeza shkencore, debate publike, etj. Staf i rregullt akademik është: Prof. Dr. Sadik Haxhiu, Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka, Prof. Ass. Dr. Fejzullah Hasani, Prof. Asoc. Dr. Urtak Hamiti, Prof. Asoc. Dr. Albulena Hajdari, Prof. Ass. Dr. Ardian Emini, Prof. Ass. Dr. Fatmire Krasniqi, Prof. Ass. Dr. Selim Daku, Prof. Ass. Detrinë Alishani Sopi, Prof. Asoc. Dr. Fadil Osmani, Prof. Asoc. Dr. Liridon Dalipi, Prof. Ass. Dr. Vaxhid Sadriu dhe Prof. Ass. Dr. Valbonë Zeqiraj.

Gjithsesi, viteve në vijim planifikojmë zgjerimin e stafit akademik gjithnjë duke synuar zhvillimin e programeve të reja studimore.

6. Studentët

Vend të posaçëm në strukturat organizative të UKZ-së por edhe të Fakultetit Juridik i është kushtuar pjesëmarrjes aktive së studentëve. Në bazë të *Statutit të Universitetit*, dy përfaqësues student janë anëtarë me të drejtë vote në organin më të lartë të Universitetit – Senatin; në Këshillin Drejtues është një anëtar-student vëzhgues; në Komisionin për studime, dy studentë marrin pjesë me të drejtë vote si dhe në Këshillin e Fakultetit me të drejtë vote marrin pjesë 2 përfaqësues të studentëve.

Në bazë të buxhetit të UKZ, për bursa të studentëve janë paraparë shuma të caktuara monetare. Të gjithë studentët e UKZ-së që kanë notën mesatare nga 8.50 janë përfitues të bursës.

studentët e Fakultetit Juridik gjatë diplomimit dhe pas diplomimit do të përfitojnë mundësi të studimeve bachellor dhe master në universitetet e tjera evropiane me anë të projekteve ERASMUS dhe të tjera. Në kuadër të bashkëpunimit me projektet e programit ERASMUS+ dhe programet e tjera të shkëmbimit të studentëve, si partneriteti me Ohio Northern University, studentët e Fakultetit Juridik kanë ndjekur studimet bachelor dhe master dhe kanë vazhduar karrierën e tyre në Kosovë dhe UKZ, duke përfshirë kështu metoda të reja ligjërimi të fituara nga përvoja ndërkombëtare. Njëherit, UKZ ka lidhur partneritet edhe me USAID, OSBE, Ambasadën e SHBA-së në Kosovë, programin Fulbright, Programin Erasmus+, HERAS, etj. të cilat sjellin mundësi shkëmbimi të studimeve dhe përvojave me vende të ndryshme të botës.

7. Buxheti

UKZ është universitet publik dhe financohet nga Buxheti i Kosovës. MASHT cakton tarifën e shkollimit. UKZ harton Buxhetin e vet në konsultim me MASHT (në periudhën e përkohshme) dhe Ministrinë e Financave, dhe i njëjti miratohet në kuadër të *Ligjit të Buxhetit të Kosovës*. Plani i financimit të njësisë akademike të Fakultetit Juridik është pjesë e planit të financimit të UKZ. Megjithatë, synimet e gjithë stafit akademik do të jenë që edhe në të ardhmen të hyrat e UKZ-së të realizohen edhe nga angazhimi në projekte dhe forma të tjera akademike përmes të cilave do t'i kontribuohet në aspektin financiar në tërësi UKZ-së.

8. Infrastruktura: ambienti i punës, teknologjia dhe burimet e bibliotekës

Të gjithë profesorët dhe asistentët janë të vendosur në zyret e tyre të cilat i plotësojnë kushtet e punës. Personeli i rregullt akademik, nga universiteti është pajisur me lloptop me qëllim që të zhvillojnë ligjeratat përmes sistemit power point. Numri i sallave për ligjerata, për fakultetin tonë aktualisht pas zhvillimeve të fundit infrastrukturore është i mjaftueshëm për realizimin e proceseve akademike. Hapësira për ligjerata dhe ushtrime ofrojnë kushtet e mjaftueshme për organizimin e ligjëratave/ushtrimeve. Këto salla në këtë vit janë pajisur me aparaturat më moderne për ligjerata. Shpresojmë dhe do të angazhohemi që edhe në vitet vijuese do të avancojmë akoma më shumë në procesin e zhvillimit të infrastrukturës në përgjithësi.

Në anën tjetër, Biblioteka në vazhdimësi synojmë që të pasurohet me tituj të ri të punimeve shkencore të autorëve më të njohur jo vetëm të fushës së drejtësisë por edhe më gjerë.

9. Hulumtimet shkencore

UKZ ka rol dhe përgjegjësi të veçantë në përparimin dhe zhvillimin e pasurisë intelektuale, shkencore, artistike dhe kulturore, si dhe në forcimin dhe zhvillimin e

bashkëpunimit të ndërsjellë me institucionet përkatëse të botës në fushën e dijes dhe hulumtimeve shkencore. UKZ mbështetë në të gjitha format angazhimit të stafit akademik jo vetëm të Fakultetit Juridik në hulumtimet shkencore. Falë mbështetjes së tillë si dhe angazhimit të stafit akademik, periudha e vitit akademik 2024/2025 është treguar si periudhë e shkëlqyeshme e avancimit shkencor të UKZ veçanarisht falë rritjes së hulumtimeve/punimeve shkencore të stafit akademik. Për nga aspekti numerik i publikimeve shkencore Fakulteti Juridik vazhdon të tregoj rezultatet më të larta krahasimisht me të gjitha njësitë akademike të UKZ gjë që edhe në vazhdim përpjekja për zhvillim dhe avancim do të vazhdojë. Pra, edhe gjatë këtij viti akademik priten publikime të reja nga stafi akademik por edhe avansime të reja në aspektin e thirrjeve akademike.

10. Ndërkombëtarizimi

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe paraqitja e Fakulteti Juridik të UKZ-së si partner serioz nëpër organizime të konferencave ndërkombëtare, ëorkshope si dhe organizime të tjera ndërkombëtare; projektet ndërkombëtare, ku Fakulteti Juridik ka arritur që të jetë partner serioz me projekte me Ohio Northern University, USAID, OSBE, Ambasadën e SHBA-së në Kosovë, programin Fulbright, Programin Erasmus+, HERAS, etj., është tregues i fuqishëm i ndërkombëtarizimit gradual të Fakultetit Juridik. Një arritje e tillë, e cila natyrisht në këtë pjesë është përcjellur vetem në disa pika të shkurtëra i atribuohet Zyrës për bashkëpunim ndërkombëtar dhe aktivitetit të vazhdueshëm të saj. Gjithsesi, synimet për zgjerimin e një fushe të tillë do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

11. Programet aktuale aktive - viti akademik 2024/2025

Njësia akademike *Fakulteti Juridik* ka filluar së funksionuari nga data: 1 tetor 2010, përkatësisht nga viti akademik 2010/11 si degë e *Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"*. Më pas, nga data: 1 tetor 2013, përkatësisht nga viti akademik 2013/14, *Fakulteti Juridik* funksionon në kuadër të *Universitetit Publik "Kadri Zeka"*, Gjilan.

Fakulteti Juridik, përkundër sfidave nëpër të cilat ka kaluar, veçanarisht sfidave infrastrukturore megjithatë në vazhdimësi ka treguar zhvillim në aspektin e përgjithshëm akademik.

Për më tepër, po qe se realizojmë një krahasim me periudhën e fillestare të të funksionuarit të kësaj njësie akademike në raport me periudhën aktuale gjendja zhvillimore është e lartë. Për më tepër, programet studimore gjithnjë e më tepër janë zgjeruar ndërkohë që, angazhimi drejt zgjerimit dhe krijimit të programeve të reja do të jetë në fokusin kryesor edhe më tej.

Pra, zhvillimi i programeve, përshtatja me tregun e punës si dhe pranimi i stafit të ri akademik do të jetë qëllimi kryesor. Rrjedhimisht, ky është çelësi i suksesit në

zhvillimin e kuadrove shkencore por edhe kuadrove të përshtatshme për tregun e punës.

Në këtë drejtim, programet aktuale aktive janë si në vijim:

1. Fakulteti Juridik, Drejtimi i Përgjithshëm, LLB, 240 ECTS; Riakredituar për periudhën 5 vjeçare, nga data: 1 tetor 2020 - 30 shtator 2025;

Bartës të këtij Programi janë:

1. Prof. Dr. Sadik Haxhiu;
2. Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka;
3. Prof. Ass. Dr. Fatmire Krasniqi dhe
4. Prof. Ass. Dr. Fadil Osmani.

2. Programi Master Juridiko-Penal, LLM, 60 ECTS; Akredituar për periudhën 3 vjeçare, 1 tetor 2021-30 shtator 2024, aktualisht në proces të riakreditimit;

Bartëse e këtij Programi do të jetë:

1. Prof. Ass. Dr. Fatmire Krasniqi dhe
2. Prof. Asoc. Dr. Fejzullah Hasani – profesor mbështetës dhe

3. Programi Master E-Qeverisja, 120 ECTS; Akredituar për periudhën 3 vjeçare, (Program i formuar nga tri njësi akademike të UKZ-së, përkatësisht nga: *Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti Juridik dhe Fakulteti Ekonomik*), aktualisht në proces të riakreditimit;

Bartëse e Programit, e dërguar nga *Fakulteti Juridik* është:

1. Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj.

12. Krijimi i programit Bachelor - Programe i ri me fillim nga vitit akademik 2024/2025 tashmë është realizuar

Emri i programit të ri bachelor është: ***Fakulteti i Shkencave Sociale, 180 ECTS/*** (kontributin kryesor në formimin e kësaj njësie akademike e kanë dhënë profesorët e *Fakultetit Juridik*)

Bartës të ketij Programi janë:

1. Prof. Asoc. Dr. Urtak Hamiti
2. Prof. Ass. Dr. Selim Daku
3. Prof. Ass. Dr. Sylë Ukshini

Ndërkohë, stafi i lirë akademik me të cilët do të synojmë akreditimin e programeve të reja janë:

1. Prof. Ass. Dr. Liridon Dalipi;
2. Prof. Ass. Dr. Ardian Emini dhe
3. Prof. Ass. Dr. Detrinë Alishani Sopi.

13. Gjendja aktuale e ndërlidhjes së fushave drejtësi-teknologji

1. Në *Fakultetin Juridik, Drejtimi i Përgjithshëm* aktualisht në vitin e III-të të studimeve, përkatësisht në semestrin e VI-të, është përfshirë lënda studimore: ***Krimet dhe siguria kibernetike***. Pra, duke mos lënë anash ndikimin e teknologjisë në zhvillimin e përgjithshëm social dhe mundësinë e keqpërdorimit të saj në drejtim të realizimit të veprave penale, për të dhënë dije dhe njohuri te studentët tanë, gjë që ata i bënë edhe më të aftë në ushtrimin e profesionit të juristit kemi parë të rëndësishme që kjo lëndë të futet në *Planprogramin mësimor*.

Megjithatë, gjatë procesit të riakreditimit të këtij programi, proces i cili do të fillojë në vitin e ardhshëm akademik, lëndët në këtë program do të rishikohen detajisht si dhe do të ketë ndryshime rrënjësore duke marrë parasysh futjen edhe të lëndëve të reja të cilat prektin veçanarisht zhvillimet kompjuterike dhe impaktin e tyre në fushën e drejtësisë. Pra, përveç lëndës së theksuar më lartë, në planprogram do të synojmë përfshirjen edhe të lëndëve të tjera ku kemi ndërlidhje të *tekonologjise-drejtësisë*. Në mesin e lëndëve që i kemi menduar janë edhe: ***E drejta e internetit, Siguria e të dhënave, Siguria e informacionit, Etika, ligji dhe teknologjia*** etj..

2. Në ***Programin Master Juridiko-Penal***, në vitin e parë, përkatësisht semestrin e dytë të studimeve ka qenë e paraparë lënda: ***Siguria nga krimet kibernetike***. Të njëjtën lëndë e kemi paraparë edhe në programin aktual me të cilin kemi shkuar tutje në procesin e riakreditimit të këtij programi dhe

3. Në ***Programin Master E-Qeverisjaj*** aktualisht në vitin e dytë, semestrin e tretë është paraparë ***Security from Cyber Crimes***, pra nga *Fakulteti Juridik* është përcjellur kjo lëndë, përveç lëndëve të tjera që në këtë program kanë të bëjnë më teknologjinë.

14. E ardhmja dhe profilizimi – ndërlidhja me IT

1. Përmes Programit të ri bachelor *International Relations and European Studies*, 180 ECTS, në rrethanat e marrjes së akreditimit, për çka shpresojmë shumë se do e fitojmë këtë të drejtë, kërkesat për staf akademik do të zgjerohen.

Përveç stafit akademik të lirë: 1. Prof. Ass. Dr. Liridon Dalipi; 2. Prof. Ass. Dr. Ardian Emini dhe 3. Prof. Ass. Dr. Detrinë Alishani Sopi, në planin e veprimit kemi paraparë zgjerimin e stafit akademik, e përmes tyre akreditimin edhe të programeve të reja. Prandaj, synimet tona do të jetë që në të ardhmen të përgatitemi edhe për ndonjë program të masterit e që mund të jetë ndonjë program që lidhet me fushat si:

1. Siguria kibernetike;

2. Diplomacia digjitale etj..

15. E ardhmja dhe profilizimi – Marrëveshjet e UKZ-së- ndërlidhja Drejtësi-IT

Suksesi i madh i stafit akademik të UKZ-së (veçanarisht stafit akademik të *Fakultetit Juridik*) në arritjen e marrëveshjeve ndërkombëtare me shumë universitete të rajonit dhe më gjerë do të shfrytëzohet jo vetëm në procesin e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik por, edhe në hulumtimin e planprogrameve studimore të tyre gjithnjë në drejtim të sjelljes së risive në programe dhe lëndë të reja studimore edhe në *Fakultetin Juridik*. Pra, çdo ditë e më tepër jemi në proces të avansimit të përgjithshëm akademik të UKZ-së. Duke hulumtuar praktikën jashtë vendit si dhe vlerat akademike të programeve akademike të vendeve të tjera, synojmë që gradualisht t'i inkorporojmë edhe në planprogramet studimore të njësisë sonë akademike në mënyrë që të jemi në hap me trendet globale zhvillimore në rrafshin akademik.

16. Përmbledhje e planit të zhvillimit të Fakultetit Juridik

Përmes *Planit të Veprimit të Fakultetit Juridik* ndonëse në pika të shkurtëra megjithatë u ritheksuar se në fokus të kësaj njësie akademike mbeten: respektimi i kornizës normative në nivel të UKZ-së gjatë zhvillimit të të gjitha aktiviteteve akademike; do të respektohet dhe do të implementohet në praktikë vizioni, misioni dhe qëllimet fundamentale të UKZ-së e në këtë rast edhe të njësisë akademike, pra Fakultetit Juridik. Gjithësesi, synimet për avancimin në menaxhimin e cilësisë brenda programeve studimore, zhvillimi i stafit akademik, mbështetja e studentëve, ngritja buxhetore, përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës si dhe zhvillimi gjithnjë e më i madh në fushën e hulumtimeve shkencore, me theks ndërkombëtarizimin jo vetëm të UKZ-së në tërësi por edhe të kësaj njësie akademike në veçanti, do të jenë aktivitetet e vazhdueshme të synuara.

17. Përkushtimi për rishikim të vazhdueshëm, adaptim dhe përmirësim të tij

Plani i Veprimit i Fakultetit Juridik ndonëse është i prezantuar në pika të shkurtëra megjithatë, përpjekjet për rishikim të vazhdueshëm të tij, përmirësim, adaptim dhe zhvillim sa më adekuat të tij do të jenë vazhdimisht në fokusin e stafit akademik të Fakultetit Juridik.

18. Plani i Veprimit i Fakultetit Juridik 2024/2025, pas miratimit nga Këshilli i Fakultetit Juridik i detajuar dhe i paraqitur në mënyrë pasqyrore:

PRIORITETET	Nr.	VEPRIMI	MASAT	AFATI	BARTËSIT	MBIKËQYRJA	Aktivitetet në lidhje me planin e veprimit	Realizimi			Nuk është realizuar	Vërejtje:
								Plotësisht	Pjesërisht	Në proces të		
1. Universiteti, shoqëria dhe tregu i punës	1.	Bashkëpunimi me biznese dhe institucionet relevante	Rishikimi, plotësimi dhe ripërtëritja e marrëveshjeve	Sipas dispozitave të marrëveshjes	Prorektorët Dekanët	Rektori	Aplikohet	+				
	2.	Puna praktike për studentët	Koordinatori i UKZ-së zhvillon aktivitete për punë praktike.	Para fillimit të semestrit	Dekani Prodekani Koordinatori	Rektori Dekani		+				
	3.	Këshilli Konsultativ i Bizneseve	Organizimi i takimeve vjetore	Të paktën një herë në vit		Rektori Dekanët Kryetari i KKB	Rektori Prorektori për financa Dekani	Aplikohet				Në nivel të UKZ
	4.	Publikimet e stafit Akademik të UKZ-së	Mbështetja për publikime dhe hulumtime shkencore.	2024/2025		Rektori Prorektorja për Culësi dhe Hulumtimet e Shkencore Kryetari i KB Senati	Këshilli botues	Aplikohet	+			Në nivel të UKZ

	5.	Aktivitetet e Zyrës për Kërkime Shkencore dhe projekte	Subvencionimi i stafit akademik për publikimet shkencore	2024/2025	Prorektor ët Dekanët Stafi Akademik	Rektori	Aplikohet	+						
1. Universiteti, shoqëria dhe tregu i punës	6.	Alumni	Aktivitetet në kuadër të Zyrës së Karrierës - Aktiviteti i Zyrtarit për Alumni - Takime të rregullta vjetore	2024/2025	Prorektor ët Sekretari Stafi Akademik Zyrtari për Alumni	Rektori	Apliko het	+						
	7.	Aktivitetet e Bordit Industrial	Takimet Përfshirja ne aktivite akademike	2024/2025	Rektori Prorektor ët Dekanët Kryetari i BI	Rektori	Apliko het					Jashte fushes se Juridikut		
	8.	Statuti i UKZ-së i miratuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (dhjetor 2020). Të aplikohet	Në fuqi	KD	Rektori	Është realizuar	+						
	9.	Organizimi i përvjetorëve të themelimit të UKZ-së	Ceremonia e themelimit Ceremonia jubilarë e themelimit te UKZ-së	Çdo vit- mars Cdo 5-10 vite	Rektori Prorektor ët Dekanët Sekretari	Rektori KD	Apliko het	+						
	10.	Konferenca e Rektorëve te Universiteteve Publike te Kosovës	Rektori i UKZ-se merr pjesë në Konferencën e rregullt të Rektorëve	2024/2025	Rektori	Rektori	Apliko het						Nivel Rektorati	

	11.	Ndarja e bursave për studentet	Bursa universitare te studenteve Bursa për studente te dalluar	Çdo vit akademik-nëntor	Rektori Dekanët	Rektori	Apliko het	+					
	12.	Promovimi i UKZ-se ne shoqëri	<ul style="list-style-type: none"> - Panairi i Tregut të Punës në Prishtinë - Panairi Virtual - Kampanja e UKZ-së për nxënësit e shkollave të mesme - Ndarja e mirënjohjeve nga Rektori për Personalitete Shquara - Përgatitja e broshurës së UKZ-së 	Para çdo fillim viti akademik	Dekanët Sekretari Zyra për marrëdhënie me publikun Studentët	Rektori	Apliko het	+					
	13.	Ceremonia e Diplomimit	Organizim i ceremonisë	Çdo vit akademik	Menaxhmenti i UKZ-se	Rektori KD	Apliko het	+					
	14.	Bashkëpunimi me Kryetarët e Komunave	<ul style="list-style-type: none"> - Takimet - Marrëveshjet me kryetarët - Marrëveshjet me Drejtoritë Komunale te Arsimit 	2024/2025	Rektori	Rektori	Apliko het	+					
	15.	Vazhdimi i bashkëpunimi me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike	Nënshkrimi i marrëveshjeve mbi bashkëpunimin në periudhën e ardhshme	2024/2025	Rektori	Rektori	Të Apliko het	+					

	16.	Guest Speaker	Ftohen personalitete te njohura për ligjërime	Ne vazhdimësi 2024/2025	Menaxhmenti Koordinatori Guest Speaker	Rektori	Apliko hen	+				
	17.	Promovimi i librave nga autorë të ndryshëm në ambientet e UKZ-së	Organizimi i promovimeve	Në vazhdimës 2024/2025	Prorektorët Dekanët Sekretari	Rektori	Apliko hen	+				
	18.	Takimet e Dom Mikel Tarabulluzit	Bashkë organizimi i takimeve te Dom Mikelit	Çdo vit përfshirë edhe vitin 2024/2025	Menaxhmenti	Rektori	Apliko het	+				
	19.	Shënimi i fillimit te vitit te ri akademik	Organizimi i pritjes solemne të studenteve të rinjë	Çdo tetor, përfshirë 2024/2025	Rektori Dekanët Stafi akademik	Rektori	Apliko het	+				
	20.	Zgjedhjet e përgjithshme ne UKZ	Shpallja e zgjedhjeve	Pas çdo mandati	Sekretari KD	Sekretari i Përgjithshëm	Apliko het	+				
	21.	Akreditimi Institucional	Akreditimi institucional është arritur për vitet 2024/2029	Qershor 2024 dhe vazhdon...	Komisioni për ri akreditim institucional	Rektori, Prorektorët, Dekanët	Apliko het	+				

	22.	Hartimi i rregulloreve për funksionimin e aktiviteteve specifike të UKZ-se :	Formimi i Komisioneve për hartimin e rregulloreve të reja dhe rishikimin e rregulloreve ekzistuese	2024/2025	Zyra ligjore ZBNJ Zyra e financave Zyra për Zhvillim Akademik Krijimi i komisioneve të veçanta	KD Rektori Prorektorët dhe Sekretari i përgjithshëm	Apliko het			+		
2. Programet Studimore	23.	Ri/Akreditimi i Programeve Studimore - Funksionimi i Komisioneve dhe aktiviteteve të Kordinatorve për Cilësi	Formimi i Komisioneve për akreditim/riakreditim të programeve dhe bashkëpunimi me Kordinatorët e cilësisë nëpër NJA Deklarimi i Stafit Akademik në AKA	Përditësimi sipas kërkesave të AKA	Prorektorët Dekanët ZZHA	Rektori Senati	Apliko het	+				
	24.	Akreditimi i Programeve të Reja	Masat në raport me politikat menaxheriale në nivel të UKZ-së	2024/2025	Prorektorët Dekanët ZZHA	Rektori Senati	Të Apliko het		+			
	25.	Fizibiliteti i programeve studimore	- Studimi i fizibilitetit për programet ekzistuese - Studimi i fizibilitetit për programet e reja	Ne proces...	Dekanët Zyra për ZHA	Rektori	Ne proces		+			

26.	Studimet e doktoratës	Universitete tjera për studime te përbashkëta te doktoratës Avancimi i vazhdueshëm i stafit akademik	2024/2025	Rektori Prorektor ët Dekanët	Rektori	Ne proces			x		
27.	Familjarizimi i stafit akademik me standardet për akreditim	Organizimi i punëtorive me te gjithë bartësit e programeve	2024/2025	Stafi Akademik Dekanatet ZZHA	Rektori Sekretari i Përgjithshëm	Të Apliko het	+				
28.	Provimi pranues për studentet e rinjë	- Ushtrime vullnetare nga studentet për aplikuesit e rinjë - Organizimi i kampanjës Dita Informuese e UKZ-se	2024/2025	Zyra për marrëdhënie me publikun Studentet	Rektori Prorektori	Të aplikohet	+				
29.	Kampanja e UKZ-së për nxënësit e shkollave të mesme	Organizohen sesione informuese me nxënësit neper shkollat e mesme	Para provimeve pranuese	Zyra per mardheni e me publikun Studentet	Rektori Dekani	Të Apliko het	+				
30.	Lista e stafit akademik te rregullt dhe te angazhuar	Dorëzimi i listatave te stafit akademik, të rregullt dhe të angazhuar në Zyrën e TI deri më 12 tetor - Vleresimi i performances	Tetor 2024/2025	Dekanët		Të Apliko het	+				

	31.	Lista e stafit akademik te rregullt dhe te angazhuar në Universitete tjera	Sekretari e siguron vendimin për ata që duan të angazhohen në një universitet a kolegji tjetër. - Angazhimi i stafit jashtë UKZ behet vetëm me leje te Rektorit, edhe ate jashtë orarit te rregullt te punës.	Tetor 2024/2025	Dekanët	Rektori. Prorektori për mësim	Të Apliko het				+	
